



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:252312

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05490422

C-IV-14-6588

Ankuesi

I E, Fshati Zh, Viti

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 21 mars 2024 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e ankuesit dhe ndryshohet **Vendimi i Autoriteti i Likuidimit, nr. GJI035-0155, i datës 01 tetor 2014.**

II. OBLIGOHET e paditura AKP që ankuesit **I E** në emër të kompensimit të dëmshpërblimit për ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së punës, t'i paguaj shumën prej **600.00 Euro**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj **shumën prej 60.00 Euro** të cilat do të paguhen në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave, sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së (Ligji nr. 04/L-034).

Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit

III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 20 tetor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI035-0155, të datës 01 tetor 2014, të Autoritetit të Likuidimit me të cilin ka kërkuar dëmshpërblimin

për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 600.00 Euro, nga N.SH.-N.B.I “Agromorava” (në likuidim). Ankuesi e kundërshton vendimin e AL-së për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, dhe aplikimit jo të drejtë dhe të gabuar të drejtës materiale. Ankuesi pohon se kërkesa e tij nuk është parashkruar dhe se ai me njoftimin e 25 nëntor 2005, është njoftuar se “Shumat pagat që ju janë borxh punëtorëve do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të njoftoheni kur të fillojnë këto procedura”. Ankuesi pohoi se në afatin ligjor një gjë të tillë e ka bërë. Me tej pohon se vendimi i AL nuk ka kurrfarë baze ligjore sepse siç thuhet në vendimin e komisionit se ka qenë dashur që në procedurë gjyqësore të realizohen këto kërkesa por kjo nuk është thënë në njoftimin e AKP-së, e as në asnjë vendim të saj, por është thënë kjo e drejtë do të realizohet pasi ndërmarrja të filloje procedurën e likuidimit. Ankuesi propozoi që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe ti njihet e drejta në kompensimin e kërkuar, me kamatë ligjore si dhe ti njihen shpenzimet e procedurës.

Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar:

- Vendimin e kundërshtuar të AL-se nr. GJI035-0155, të datës 01 tetor 2014
- Njoftimin për ndërprerjen e punësimit në NSH të datës 25 nëntor 2005,
- listën përfundimtare të punëtorëve të përfitimit të 20%,
- kopjen e letërnjoftimit.

Me 06 prill 2023, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje në ankesë, në të cilën i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, dhe të dispozitave ligjore. AKP-ja e mbështet në tërësi vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke iu referuar Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, nenit 36.2.1, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar, për rrjedhën e afatit të parashkrimit. Me tej e paditura pohoi se nuk ka prova që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare të parashkrimit, pra tri vite nga qershori i vitit 2008. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Gjykata gjen se AL në rastin e vendosjes së kërkesës të ankuesit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 600.00 Euro, pa ndonjë arsye këtë kërkesë e ka refuzuar si të pavlefshme dhe pa dhënë më këtë rast ndonjë arsyetim të bazuar. Arsyetimi i vendimit nga ana e AKP-së, se ankuesi është dashur kërkesën e tij ta parashtoj me kohë në gjykatë apo tek organi kompetent dhe se e njëjta është parashkruar sepse në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta zyrtare nr.53 të vitit 1976) kjo është dashur të bëhet në afat prej 3 vite, nuk është i qartë dhe nuk përmban arsyet bindëse për refuzimin e kësaj kërkesë.

Me 26 gusht 2014, ankuesi kishte paraqitur kërkesën në AL për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, që është brenda afatit për paraqitjen e kërkesave tek AL. Gjykata konsideron si të drejtë procedurën e ndjekur nga ana e ankuesit kur i është drejtuar AL me kërkesën për dëmshpërblim.

Gjykata gjen si të pa bazuar dhe nuk e aprovon pretendimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës së kërkesës së ankuesit është e parashkruar. Thirrja në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, sipas gjykatës nuk është i argumentuar, pasi që me këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (lex specialis). Neni 40.1.6.2. i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në parasheh të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punëtorëve. Po ashtu me të njëjtin Ligj është parapara që kërkesat e tilla punëtorët në pajtim me procedurat e Likuidimit i paraqesin tek AL kur N.SH hynë në likuidim. Këtë e ka bërë ankuesi, prandaj nuk ka pasur parashkrim të kërkesës meqë këtu nuk kemi të bëjmë me paga të papaguara që NSH i ka mbetur borxh ankuesit, por kemi të bëj me dëmshpërblim të cilin vet Ligji i AKP u njuh punëtorëve, prandaj thirrja e AL së në nenin 608 është e pa bazuar.

Ankuesi me njoftimin e datës 25 nëntor 2005 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të N.SH-së dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj N.SH-së, duhet ta parashtojë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit. Futja e N.SH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të N.SH-së, nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtojë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me praktiken e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0304, AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168, AC-I-20-0183 etj).

Baza ligjore për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së punësimit ekziston në Neni 40.1.6.2. i shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse “ *janë pushuar nga puna si*

rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ”. Privatizimi është një ndër veprimet e AKP-së të parapara me nenin 6.2.1 të Ligjit për AKP-në, prandaj kërkesa për dëmshpërblim e ankuesit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është vlefshme dhe e bazuar.

E paditura as në vendimin e saj e as në mbrojtje në ankesë nuk e ka kontestuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe as lartësinë e pagesës për dëmshpërblim të ankuesit, prandaj nuk ka nevojë të provohet me tepër.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 60.00 Euro, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore

Në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është i liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit nuk e kalon vlerën mbi 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare